**ERHARD ARENDT** wurde im Juni 1941 in Hemer – NRW geboren. Sein Vater, der vor dem Krieg sich eine kleine Gießerei aufgebaut hatte aber nicht so regimetreu wie die anderen war, bekam keine Aufträge und musste die Firma schließen. Er wurde Soldat, später Frührentner und starb als Erhard 16 Jahre alt war. In dieser Zeit fing er an Gedichte zu schreiben, zeichnete Blätter, Landschaften, Gesichter, skurrile tierähnliche Figuren. Er las Wildwestro-mane, fand sie irgendwann langweilig, las „Der Graf von Monte Christo“ und anderes. Er fand in der Stadtbücherei Bücher über Kant, Nietzsche, las sich quer durch die Philosophie, war an Soziologie interessiert, Politik, Religionen, sehr auch an Psychologie und Kunst. Er beendete eine Lehre als Dreher, doch war er ungezielt unzufrieden mit seinem Leben. So begann er auf der Abendschule eine Technikerausbildung. Es war ihm zuwenig, also wurde in der Abendschule „die mittlere Reife nachgeholt“, er wollte Ingenieur werden. Während Erhard Arendt dann alle nötigen Praktika absolvierte, besuchte er Malkurse und Kurse in denen mit Ton gearbeitet wurde. Er entschloss sich Kunst zu studieren. Trotz eines sehr intensiven Studiums öffnete sich die Tür zum Paradies für ihn... Sein eigentliches Leben begann wirklich auf dem Fundament einer nicht sehr glücksvollen Jugend. Sein Studium der Plastik und Bildhauerei in Dortmund beendete Arendt 1969. Ab 1996 Wohnhaft in Iserlohn, wo er als Lehrer tätig war. Jahre später studierte er Gesellschafts- und Erziehungs-wissenschaft an der Ruhruniversität Bochum. Künstlerisch hat Erhard Arendt sich vielseitig erfolgreich in der Öffent-lichkeit präsentiert. Es gab viele Einze-lausstellungen und Teilnahmen an Gruppenausstellungen im Inn- und Ausland, in den frühen Jahren auch literarische Lesungen, Veröffentlichungen in Zeitungen und Zeitschriften, eine Anthologie, und Lyrikhefte im Selbst-verlag. Es mögen sicher tausend Arbeiten von ihm auf der ganzen Welt Wohnungen schmücken. Erhard Arendt war in seiner Stadt jahrzehntelang die UNRUHE und hatte sich in politischen, kulturellen Bereichen und in Selbsthilfe-gruppen engagiert. Obwohl er sich seit 2001 im Ruhestand befindet, ist Erhard Arendt sehr aktiv als freischaffender Künstler.

## trauert mit mir

trauert mit mir
ich weine um die die immer verlieren
egal
wer der sieger ist
IRAK - IRAN - KOSOWO .................
wir

## pikëllohuni me mua

pikëllohuni me mua
që vajtoj për humbësit
paçka
cili është fituesi mbi dhe
IRAK - IRAN - KOSOVË ..................
ne



## unser leben

unser leben
ist ein ausnahmezustand
einmalige zustandsform
es beginnt
endet

es gibt keine probe
kein drehbuch
keine wiederholung
keine zugabe
du betrittst die bühne
und gehst
mit deiner einmaligkeit
den applaus
das pfeifen
hörst du nicht mehr

## jeta jonë

jeta jonë
është përjashtim
formë e papërsëdytshme
nis
mbaron

s’ka prova
s’ka skenar
as përsëritje
as shtojcë
ti del në skenë
e merr udhë
drejt të amshimtës ikje
pa mundur më të dëgjosh
fishkëllima
duartrokitje

## schneckenwesengleich

schneckenwesengleich
ziehen wir durchs land
irren umher
im garten des lebens
sternschnuppengleich
werd ich mich nicht überleben

## si kërminj

zwarremi
si kërminjtë e gjorë
kopshtit të jetës
sillemi kot
si meteor
nuk mbijetohet dot

**ERHARD ARENDT** u lind në qershorin e vitit 1941 në Hemer të Nordreinwestfalen. Ati i tij kishte ndërtuar para luftës një fonderi, por ngaqë nuk ishte dhe aq besnik ndaj qeverisë sikurse të tjerët, përjetoi edhe ndërprerjet e porosive, ndaj dhe u detyrua ta mbyllte firmën. Punoi si ushtar, u pensionua para kohe dhe vdiq kur Erhardi sapo i kishte mbushur të gjashtëmbë-dhjetat, moshë kjo, kur ai kish filluar të shkruante poezi, të vizatonte gjethe, peisazhe, portrete apo figura të çuditshme përafruar kafshëve. Lexoi romane nga perëndimi i egër, të cilët dikur iu dukën mërziprurës, por edhe „Konti i Monte Kristos“ e shumë të tjerë. Në bibliotekën e qytetit gjeti libra mbi Kantin dhe Niçen, u dha mbas filozofisë, por ishte i interesuar edhe për sociologjinë, politikën, fetë, e mbi të gjitha për psikologjinë dhe artin. Mbaroi një kurs për tornitor, por nuk ishte aspak i kënaqur me jetën e tij të paorientim. Në shkollën e mbrëmjes u formua si teknik. Kjo qe pak për të, ndaj dhe mbaroi edhe shkollën e mesme, pasi donte të bëhej inxhinier. Pasi bëri gjithë stazhet e duhura, u regjistrua në kurset e vizatimit dhe të pikturimit me bojëra. Vendosi të studionte art. Pavarësisht lodhjes intensive studimore, për të qe hapur dera e paraj-sës… Mbi themelet e një rinie jo fort të lumtur po ngrihej tashmë jeta e tij e vërtetë. Më 1969 mbaroi në qytetin e Dortmundit studimet për pikturë dhe skulpturë. Në vitin 1969 bëhet banor i qytetit Iserlohn, ku dhe punonte si mësues. Pak vite më vonë studioi në „Ruhruniversitet“ të Bochum-it shkencat shoqërore dhe të edukimit. Prezantimi para publikut i artistit Erhard Arendt ka qenë jo vetëm i larmishëm, por edhe i suksesshëm. Ka hapur ekspozita vetjake e ka marrë pjesë edhe ekspozita grupore si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në vitet e hershme i është prezantuar lexuesit edhe me deklamim të poezive të tij, të cilat i botonte nëpër revista letrare dhe antologji. Mijëra punime të tij në pikturë, plastikë dhe skulpturë janë shpërndarë botës me misionin zbukurimi. Në qytetin e tij Erhard Arendt ka qenë PAQETËSIA për vite të tëra: angazhuar në fushën politike, kulturore dhe të vetëndihmës. Megjithëse që prej vitit 2001 ndodhet në pension, është ende tejet aktiv në degën e artit.

## schatten an der wand

schatten an der wand
licht
dazwischen ich
teils maßlos
dann wieder von falscher
bescheidenheit
mehr als nichts
weniger als alles

## hije në mur

hije në mur
dritë
mes dritëhijes unë
i pjesshmi që matësi nuk ka
e pastaj rishtas nga thjeshtësia e
sëmurë
më shumë se asgjë
më pak se gjithçka

*(Aus dem Deutschen ins Albanische übersetzt von: Shqipëroi nga gjermanishtja:* **Ferdinand Laholli**)